



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I MEDIAVE AUDIOVIZIVE

VENDIM

Nr. 70, datë 21.08.2020

PËR

**PËR SHQYRTIMIN E ANKIMIT ADMINISTRATIV TË PARAQITUR NGA
SUBJEKTI PERSON FIZIK DRITAN MEMUSHI, KUNDËR VENDIMIT NR. 3
DATË 21.07.2020 VENDOSUR NDAJ SUBJEKTIT OSHMA "TV ME KABËLL
TEPELENA SAT".**

Autoriteti i Mediave Audiovizive
I përbërë nga:

Gentian	Sala	Kryetar
Sami	Nezaj	Zëvendëskryetar
Gledis	Gjipali	Anëtar
Suela	Musta	Anëtar
Agron	Gjekmarkaj	Anëtar

Mori në shqyrtim çështjen me:

Ankues: Subjekti person fizik Dritan Memushi

Objekt: Kundërshtim i vendimit për dënimin me gjobë të vendosur ndaj subjektit OSHMA "Tv me kabëll Tepelena Sat", me nr. 3, datë 21.07.2020.

Baza Ligjore: Ligji nr. 97/2013 Për mediat audiovizive në republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Vendimi nr. 101 datë 07.06.2017 të AMA-s "Për procedurat e inspektimit të veprimtarisë audiovizive të ofruesve të shërbimit mediatik audio dhe/ose audioviziv. Kodi i procedruave administrative i Republikës së Shqipërisë. Ligji nr. 10 279, datë 20.05.2019 "Për kundravajtjen Administrative".

Në datën 14.07.2020, grupi i inspektimit të Autoritetit të Mediave Audiovizive, sipas urdhrorit të Kryetarit të AMA-s, nr. 115 datë 13.07.2020 "Për inspektimin e veprimtarisë së subjekteve (OSHMA), inventarizimin dhe sekuestrimin e pajisjeve të përdorura për ushtrimin e veprimtarive të pa licencuara/paaautorizuara", u paraqit në adresën ku janë të

instaluar pajisjet audiovizive transmetuese të subjektit person fizik z. Dritan Memushaj autorizuar për subjektin OSHMA "Tv me kabëll Tepelena Sat" në njësinë administrative Ksamil.

Në bazë të rregullores "Për procedurat e inspektimit të veprimtarisë së ofruesve të shërbimit mediatik audio dhe ose/audioviziv", inspektimi u krye në prezencë përfaqësuesit të subjektit z. Nazmi Hoxha dhe programet (kanalet) që ishin në transmetim gjatë inspektimit u mbajtën në procesverbalin e konstatimit të programeve dhe, më konkretisht, programet (kanalet) si më poshtë:

- | | |
|-----------------|---------------------------|
| 1. Report Tv | 10. Tring Shqip |
| 2. Rtsh Sport | 11. Klan Plus |
| 3. Elrodí Tv | 12. Tring 3+ |
| 4. Vizion + | 13. Rtsh Film |
| 5. Klan Tv | 14. Tring Planet |
| 6. News 24 | 15. Tring 7 News |
| 7. Tring Action | 16. Rai 1 |
| 8. Tring Kids | 17. Rai 2 |
| 9. Tring Tring | 18. Channel 21 (Gjermane) |

Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar në AMA konstatohet se subjekti, nuk disponon asnjë kontratë për të drejtën e transmetimit të programeve (kanaleve) si më poshtë:

- | | |
|---------------|--------------------------|
| 1. Rtsh Sport | 4. Rai 2 |
| 2. Rtsh Film | 5. News 24 |
| 3. Rai 1 | 6. Channel 21 (Gjermane) |

Nga gjithë sa më sipër, konkludohet se subjekti person fizik z. Dritan Memushaj, i autorizuar për subjektin OSHMA "Tv me kabëll Tepelena Sat", në çastin e ushtrimit të kontrollit, është konstatuar duke përsëritur programe (kanale) të të tretëve, për të cilat nuk ka nënshkruar kontrata/marrëveshje me mbajtësit e të drejtave të këtyre programeve, fakt ky që vjen në kundërshtim me nenin 32/6, të ligjit nr. 97/2013 "Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, sipas të cilit: "***OSHMA-të duhet të transmetojnë programet, përfshirë veprat kinematografike, në përputhje me kushtet dhe afatet për të cilat kanë nënshkruar marrëveshje me mbajtësit e të drejtave të këtyre veprave.***"

Në këto kushte, ndaj subjektit në fjalë është proceduar me Vendimin nr. 3 datë 21.07.2020, duke e dënuar me gjobë atë në masën 1.000.000 (një milion) lekë.

Kundër këtij vendimi, me shkresën nr. 2011/1 prot. datë 30.07.2020, subjekti ka paraqitur ankim administrativ, ndër të tjera duke pretenduar se:

- *Kjo gjobë është e pa përballueshme nga ne si subjekt fizik i "Tepelena Sat" dhe është falimentuese për punën tonë. Ju kujtojm se zona e Ksamilit ku është kryer inspektimi kap me një anten të thjeshtë 53 kanale të tjera të lira të pa koduara, të cilat futën edhe në dekoderat tanë dhe pajisjeve tona. Bashkëngjitur këtij ankimi po sjellim edhe kontratën që kemi bërë me RTSH e cila është depozituar pranë AMA-s.*

Pretendimet e paraqitura nga subjekti në lidhje me rishikimin e gjobës janë të pa mbështetura në prova dhe në ligj dhe nuk mund të justifikojnë ligjërisht mosrespektimin e parashikimeve ligjore. Nga ana e subjektit nuk është paraqitur asnjë provë shkresore, e tillë që të justifikojë ligjërisht pretendimet e tij.

Subjekt me shkresën nr. 2109 prot., datë 30.07.2020, vërtet ka depozituar një kontratë/marrëveshje transmetimi 1 (një) vjeçare me RTSH, por, kontrata/marrëveshje në fjalë, është depozituar mbas kryerjes së kundravajtjes administrative.

Edhe në qoftë se, kjo marrëveshje me RTSH merret parasysh nga Këshilli, subjekti vijon të mos disponojë asnjë të drejtë transmetimi për kanalet (programet) “Rai 1”, “Rai 2”, “News 24” dhe kanalit gjerman “Channel 21” të cilat janë konstatuar në transmetim gjatë kontrollit.

PËR KËTO ARSYE,

Autoriteti i Mediave Audiovizive, në bazë të nenit 19, pika 16, nenit 133, pika 11 të ligjit nr. 97/2013, “Për mediat audiovizive në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar”, Ligjit nr. 44/2015 “Kodi i Procedurave Administrative”, si dhe rregullores “Për procedurat e inspektimit të veprimtarisë audiovizive të ofruesve të shërbimit mediatic audio dhe/ose audioviziv”, miratuar me Vendimin nr. 101 datë 07.06.2017 të AMA-s, Autoriteti i Mediave Audiovizive.

VENDOSI:

1. Refuzimin e ankimit administrativ dhe lënien në fuqi të vendimit nr. 3 datë 21.07.2020 për dënimin me gjobë, në masën 1.000.000 (një milion) lekë, të subjektit person fizik Dritan Memushi, për subjektin OSHMA “Tv me kabëll Tepelena Sat”.
 2. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në gjykatë, në përputhje me ligjin nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, duke filluar nga dita e marrjes dijeni.
 3. Ky vendim përbën titull ekzekutiv.
 4. Ngarkohet administrata e AMA-s për veprime të mëtejshme sipas ligjit.
- Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryetar: Gentian

SALA

Zëvendëskryetar: Sami

NEZAJ

Anëtarë: Gledis

GJIPALI

Suela

MUSTA

(Kundër gjobës)

Agron

GJEKMARKAJ